

## PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

### **OBJEKTI I PROKURIMIT: “NDËRRHYRJE REHABILITUESE NË RRUGËT AUTO-PYJORE”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):  
45000000-7 Punë ndërtim**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 15,475,291 (pesëmbëdhjetë milion e katërqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e një) lekë pa tvsh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), autoriteti/enti kontraktor “**Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit**”, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

### **KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të LPP nr.162 datë 23.12.2020, (i ndryshuar) si dhe në nenin 26 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik...”*

b) Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; përkatësisht në vlerën **309,505.82 (treqind e nëntë mijë e pesëqind e pesë pikë tetëdhjetë e dy) lekë** të lëshuar në formën e garancisë bankare ose nga shoqëri sigurimesh të licensuara nga Autoritetet përkatëse.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 83 të LPP, (i ndryshuar) dhe në nenin 30, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël...”*

*“...Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit të kontratës. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe...”*

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:**

#### **2.1.1 Licenca profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:**

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:

**NP-1 Punime gjurmimi në tokë** (Kjo licencë është kërkuar pasi objekti përfshin punime të trupit të rrugës pyjore, të cilat konsistojnë në: gjurmime dhe shkëmbi, sistemim dhe nivelim terreni, hapje traseje në zona me relief të thyer. Këto procese janë thelbësore për ndërtimin dhe rehabilitimin e rrugëve pyjore dhe kërkojnë operatorë ekonomikë të pajisur me këtë kategori licence për të garantuar kapacitetin teknik dhe profesional për realizimin e punimeve).

**NP-4 Rrugë ura mbikalime** (Kjo licencë është kërkuar pasi objekti përfshin rehabilitimin e rrugëve auto pyjore, që përfshin: rehabilitimin e shtresave rrugore (nën-bazë, bazë, shtresë stabilizuese), sistemimin dhe profilimin e rrugës, punime për akses dhe kalueshmëri në terrene pyjore. Licenca NP-4 garanton që operatori ekonomik ka kapacitetin teknik dhe profesional për realizimin e punimeve rrugore).

**NP-12 Punime të Inxhinierisë së mjedisit** (Kjo licencë është kërkuar pasi rrugët auto pyjore zhvillohet në zona me ndjeshmëri të lartë mjedisore, ku ndërhyrjet në terren mund të shkaktojnë ndikime në ekosistem. Në këtë kuadër, punimet përfshijnë dhe kërkojnë: rehabilitimin e zonave të dëmtuara gjatë punimeve në rrugë, sistemimin dhe stabilizimin e skarpateve për parandalimin e erozionit. Këto procese kërkojnë operatorë ekonomikë të pajisur me ekspertizë në fushën e inxhinierisë mjedisore, për të garantuar minimizimin e ndikimeve negative. Kërkesa për licencën NP-12 është bërë për shkak të natyrës së punimeve në zona pyjore dhe nevojës për zbatimin e masave të inxhinierisë mjedisore, me qëllim mbrojtjen e mjedisit).

*Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi e miratuar me VKM- në, Nr. 42, date 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), si dhe në VKM nr 759, datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim” (i ndryshuar).

Gjithashtu në mbështetje të Ligjit specifik nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” (i ndryshuar), neni 8 përcaktohet se “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm

*nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit, në përputhje me standardet kombëtare ose europiane... .”*

*Kategoritë për punimet e ndërtimit dhe niveli për çdo kategori punimesh zbatimi janë përcaktuar referuar zërave të preventivit të punimeve për këtë objekt, projektit të zbatimit si dhe në mbështetje të plote të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, (i ndryshuar).*

### **2.1.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:**

a. Certifikatën e cilësisë së punimeve *SSH DIN EN UNI ISO 9001-2015 e përditësuar* (e vlefshme) ose ekuivalent. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

b. Certifikatën për Sistemin e menaxhimit të mjedisit *SSH/DIN/EN/UNI ISO 14001-2015 e përditësuar*, e vlefshme ose ekuivalent. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akredituese, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

c. Certifikatën *SSH/DIN/EN/UNI ISO 45001:2018 e përditësuar*, (SSH/DIN/EN/UNI ISO 45001 - 2023) e vlefshme, ose ekuivalent (Mbi Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë ose ekuivalent). Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

\*Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, Operatori ekonomik do të paraqesë ISO-t në bazë të zërave të punimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH/DIN/EN/UNI/ISO mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

**Argumentimi:** *Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), si dhe nenit 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), autoriteti kontraktor ka të drejtë të kërkojë nga operatorët ekonomikë paraqitjen e certifikatave të cilësisë, menaxhimit mjedisor dhe të shëndetit dhe sigurisë në punë, me qëllim vërtetimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale për realizimin me sukses të kontratës.*

*Ky kriter është vendosur për të garantuar që operatorët ekonomikë pjesëmarrës zbatojnë standarde të njohura ndërkombëtare në lidhje me cilësinë e punimeve, mbrojtjen e mjedisit dhe sigurinë e punonjësve gjatë realizimit të kontratës.*

*Me anë të kësaj sigurojmë që operatori ekonomik disponon procese të strukturuar dhe të kontrolluara për menaxhimin e cilësisë së punimeve, duke minimizuar riskun e defekteve dhe moskonformiteteve gjatë zbatimit të projektit; Garantojnë që aktiviteti zhvillohet në përputhje me kërkesat për mbrojtjen e mjedisit, duke reduktuar ndikimet negative dhe duke respektuar legjislacionin përkatës në fuqi; Sigurojnë zbatimin e standardeve për shëndetin dhe sigurinë në punë, duke parandaluar aksidentet dhe rreziqet profesionale në*

kantier. Kërkesa që këto certifikata të jenë të lëshuara nga organizma të akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtarë të njohur nga Republika e Shqipërisë, vendoset për të garantuar vlefshmërinë, besueshmërinë dhe njohjen ligjore të tyre.

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% vlerës e fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, sa 40 % vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

*Argumentimi:* Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/b dhe 3, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Per prokurimin publik", i ndryshuar në të cilin përcaktohet se:

"1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës.

**Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqënëse autoriteti jonë kontraktor kërkon që të garantohet se operatori ekonomik ofertues e ka kapacitetin ekonomik të nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit, njësia e prokurimit vendosi që të hartonte dhe përcaktonte këtë kërkesë për kualifikim.**

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit "Procedure e Hapur" ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 43, pika 1 e 2 "Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare" të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar si dhe Kreut II "Kufijtë monetarë" të VKM nr. 291, datë 15.05.2024 "Për përcaktimin e kufijve monetare në procedurat e prokurimit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se:

Neni 43

Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare

Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, ne procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...;

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.;

## KREU II

### KUFIJTË MONETARË NË SEKTORIN KLASIK

1. Kufiri i lartë monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:

a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 603 000 000 (gjashtëqind e tre milionë) lekë;

b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 16 000 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë) lekë.

2. Kufiri i ulët monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:

a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë;

b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

Lidhur me vitet financiare për të cilat kërkohet që të jetë e realizuar xhiro e kërkuar, njësia e prokurimit duke ju referuar përcaktimeve të nenit 43, të VKM nr. 285, datë 15.06.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar ku është përcaktuar se deklarata e xhiros vjetore mund të kërkohet deri në tre vitet e fundit financiare, si dhe nisur nga përcaktimi i pikës 7 të Rekomandimit të APP Nr.7998 datë 24.12.2021 "Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime" ku përcaktohet se në nenin 19 të ligjit nr 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, deklarata vjetore e të ardhurave nga subjektet tatim paguese deklarohet në organe tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, prandaj njësia e prokurimit meqënëse procedura e prokurimit do të zhvillohet në prill të vitit 2026 dhe tatimpaguesit kanë afat deri më 31 mars 2026 të deklarojnë xhiron e realizuar në vitin 2025 përcaktoi si 3 (tre) vite të fundit financiare vitet 2023, 2024 dhe 2025.

**Lidhur me vlerën e xhiros vjetore të përcaktuar, meqënëse procedura e mësipërme e prokurimit është nën kufirin e ulët monetar u përcaktua që vlera e xhiros vjetore të jetë sa 40% e vlerës së fondit limit.**

**2.2.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2023, 2024, 2025) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke

paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

**2.2.3** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat vendore për adresën ku ai ushtron aktivitet, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar për vitin 2025, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006" Për sistemin e taksave vendorë, i ndryshuar, ku nëse kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë vërtetim/e lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 8. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Dokumentacioni provues, për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është në përputhje me nenin 76, pika 2, gërma b të LPP, i ndryshuar si dhe në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore“ i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore në të gjitha vendet ku ushtron aktivitet ekonomik sipas të dhënave të QKB-së.

## **2.3 Aftësitë teknike:**

**2.3.1** Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a. Punë të ngjashme në punime rrugësh ose rehabilitime terreni, për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- b. Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

**Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentat e mëposhtme:**

- Për kontrata të realizuara me *ente/institucione publike*, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
  - Formularin e vlerësimit për realizimin e punimeve, sipas shtojcës 9, (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer)
  - Kontratën/at e sipërmarrjes.
  - Situacionin përfundimtar
  - Aktin e kolaudimit
  - Certifikatën e marrjes në dorëzim / Certifikatën e Përkohshme të marrjes në dorëzim.

*\*Shënim: Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punimeve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

- Për kontrata të realizuara me *sektorin privat*, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
  - Kontratën/at e sipërmarrjes,
  - Situacionin përfundimtar,
  - Aktin e kolaudimit,
  - Faturën/at tatimore përkatëse të deklaruara në organet tatimore.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

Kontratën e bashkimit të operatorëve ekonomik dhe prokurën e posaçme si dhe preventivin e ndarjes së punimeve të marra përsipër nga secili operator ekonomik të deklaruara në fazën e tenderimit;

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e Bashkimit të operatorëve ekonomikë si dhe prokurën e posaçme të deklaruar në fazën e tenderimit.

- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, (i ndryshuar) dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (i ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.*

*Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin kontraktor, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (i ndryshuar), parashikohet se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë*

duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

Gjithashtu Autoriteti Kontraktor në funksion të kërkesës për të provuar përvojën e mëparshme të operatorëve ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit ka kërkuar që në rastin e paraqitjes së punëve të ngjashme me kontrata bashkëpunimi ku operatori ekonomik ka marrë përsipër të kryejë një përqindje të caktuar dhe zëra specifikë të punës në tërësi ka kërkuar si dokumentacion shoqërues dhe **kontratën e bashkëpunimit dhe preventivin e ndarjes së punimeve të marra përsipër nga secili operator ekonomik të deklaruar në fazën e tenderimit**. Sqarohet se për të vërtetuar faktin nëse ky operator ekonomik përmbush punët e ngjashme të kërkuara ky dokumentacion është i nevojshëm për autoritetin kontraktor. Në mbështetje të Nenit 88 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), aktet ligjore parashikojnë formën dhe dokumentacionin e nevojshëm për të ofertuar si bashkim operatorësh ekonomik (kontrata e bashkëpunimit si dhe përcaktohen elementet konkrete që do të kryejë secili prej operatorëve ekonomik në bashkëpunim). Pra referuar këtij dokumentacioni përcaktohet saktësisht përqindja dhe elementët konkretë në zëra punimesh që operatori ekonomik ka marrë përsipër të realizojë në këtë kontratë duke i krijuar mundësi autoritetit kontraktor të verifikojë dhe vlerësojë nëse punimet e marra përsipër për tu realizuar në këtë kontratë janë të ngjashme me punimet e kontratës objekt prokurimi. Thënë kjo operatori ekonomik mund të plotësojë vlerën në përqindje të punës që kërkohet të realizohet por ndërkohe në kontratën e realizuar në bashkëpunim mund të mos ketë realizuar zëra të ngjashëm me kontratën objekt prokurimi duke mos provuar përvojën e suksesshme për punë të ngjashme.

Gjithashtu në kontratat e lidhura si nënkontraktor është kërkuar kontrata bazë ndërmjet kontraktorit dhe Autoritetit kontraktor si dhe miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga autoriteti kontraktor. Referuar Nenit 126 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 pika 3 përcaktohet se autoriteti kontraktor përpara lidhjes së nënkontratës me operatorin ekonomik fitues të kontratës publike miraton nënkontraktorët e mundshëm. Çdo nënkontraktim që nuk lidhet sipas kësaj dispozite nuk është i vlefshëm dhe nuk mund të vlerësohet nga autoriteti kontraktor si pune e ngjashme pasi bie ndesh me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për prokurimin publik. Nisur nga këto dispozita ligjore autoriteti kontraktor ka kërkuar dokumentacionin e nevojshëm për verifikimin dhe vlerësimin e punëve të ngjashme të realizuara nëpërmjet kontratës me nënkontraktim.

### 2.3.2 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë:

a) Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e punimeve, objekt kontrate, duhet të ketë të punësuar minimumi 16 (gjashtëmbëdhjetë) punonjës, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

Listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit të deklaruar.

*Shënim: Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit.*

Objekti i kontratës përfshin ndërhyrje në një gjatësi rreth 25 km rrugë pyjore, të shpërndara në disa zona, çka kërkon organizimin e punimeve në disa fronte pune njëkohësisht dhe zhvillimin paralel të proceseve si: gërmime, sistemim traseje, ndërtim shtresash rrugore, stabilizim skarpatah, transport materialesh.

Në këtë kuadër, është kërkuar disponimi i një sërë mjeteve dhe pajisjesh. Mjete janë të domosdoshme për realizimin e proceseve kryesore të punimeve dhe për përballimin e ndërhyrjeve në disa segmente njëkohësisht.

Paralelisht, kërkesa për një numër minimal prej 16 (gjashtëmbdhjetë) punonjësish është vendosur në funksion të operimit të këtyre mjeteve dhe organizimit të punës në terren. Çdo mjet kryesor kërkon operator ndërsa proceset ndihmëse kërkojnë punëtorë të thjeshtë, staf teknik, si dhe shoferë për transportin e materialeve. Duke marrë në konsideratë numrin e mjeteve të kërkuara dhe shpërndarjen e punimeve në disa zona, ky numër përbën minimumin e nevojshëm për funksionimin normal të kantierit dhe zhvillimin paralel të proceseve të punës.

Gjithashtu, afati i realizimit të punimeve është përcaktuar 3 muaj, duke marrë në konsideratë nevojën për përfundimin e punimeve përpara periudhës së reshjeve intensive të stinës së vjeshtës, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në ecurinë e punimeve (gërmime, transport, kompaktim dhe stabilitet të trupit të rrugës). Afati 3 (tre) mujor për rehabilitimin e rrugëve auto- pyjore, është përcaktuar duke marrë në konsideratë rëndësinë funksionale dhe emergjente të këtyre akteve. Përfundimi i punimeve brenda këtij afati synon të garantojë sigurinë e aksesit të plotë dhe të shpejtë për ndërhyrje në kuadër të luftës kundër zjarrve e cila paraqet një rrezikshmëri të lartë në zonat pyjore në periudhën e verës. Ky afat lidhet drejt për drejt me nevojat operative dhe mbrotjen e territorit. Për këtë arsye kërkohet një intensitet i lartë pune dhe kapacitet i mjaftueshëm teknik dhe njerëzor.

**b)** Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë, si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontratë pune e vlefshme;
- Diplomë;

**c)** Të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, CV, diplomë përkatëse si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- 1 (një) Inxhinier ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier mjedisi

• *Shënim: Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit.*

d) Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vërtetuar me kontratë punë të vlefshme, një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/ certifikatë/ diplomë) nga organe kompetente si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

STAF TEKNIK	NUMRI
Teknik Ndërtimi	1
Teknik Topograf	1
Eskavator	1
Automakinist	1
Shofer	2
Puntor të thjeshtë	8

\* Për punonjësin manovrator/shofer, ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratë individuale të punës;
- leje drejtimi, certifikatë e aftësisë profesionale/Patentë Manovrimi nga DPSHTRR. (Në rastin kur punonjësit Manovrator/shoferë janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qira), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).
- Për punonjësit teknik/ndërtimi/topograf/ diplomë të shkollës së mesme profesionale si dhe të jenë të pajisur me, Dëshmi të Sigurimit Teknik e lëshuar nga ISHTI ose nga një trup certifikues e akredituar nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

*Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.*

e) Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë pjesë të stafit të tij ose si staf mbështetës si më poshtë:

- 1 (një) punonjës me certifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr: 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier"

*\*Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Këto kritere janë vendosur në mbështetje të Ligjit nr.10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” si dhe të VKM Nr.312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”. Njësia e prokurimit gjykon se për mbarëvajtjen e punimeve, me qëllim garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen e shëndetit, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident si dhe në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni sektorial në fuqi, është e nevojshme prezenca e ekspertit për ndihmën e parë dhe ndërhyrjet ndaj emergjencave dhe ekspertit për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në kantierin e punimeve.

Në mbështetje të Ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” si dhe të VKM Nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier” Autoriteti kontraktor duke vlerësuar të gjitha detyrat që mbulojnë këta punonjes për sigurinë në kantier ka gjykuar të jenë pjesë e stafit një punonjës i certifikuar pasi duhet të kryejë funksione të tilla të rëndësishme në kantier si mirëmbajtjen e kontrollin para fillimit të punës dhe kontrollin periodik të impianteve dhe pajisjeve të punës me qëllim eliminimin e defekteve që mund të dëmtojnë sigurinë ose shëndetin e punëmarrësve; caktojnë kufijtë dhe përgatitin zonën e stoqeve dhe të depozitimit të materialeve, në veçanti kur bëhet fjalë për lëndë dhe substanca të rrezikshme; përshtatin në funksion të zhvillimit të kantierit, të kohëzgjatjes efektive që duhet t'i jepet llojeve të ndryshme të punës ose fazave të punës; kryejnë bashkëpunimin midis punëdhënësve dhe punëmarrësve të pavarur; kryejnë bashkëveprimin me aktivitetet që ndodhin në vendndodhje, brenda dhe në afërsi të kantierit. **Operatori ekonomik duke angazhuar punonjës të kualifikuar dhe me eksperience, vlerëson rëndësinë e projektit në fjalë rrit performancën e realizimit të projektit, rrit vlerën e investimit njerëzor në projekt dhe në këtë mënyrë siguron suksesin e përbashkët.**

**2.3.3** Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës konkretisht:

Nr.	Lloji i mjetit/pajisjes teknike	Statusi	Sasia
1.	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimum 7ton	Në pronësi ose me qira	2
2.	Kamionçinë me kapacitet mbajtës minimum 1-1.5 ton	Në pronësi ose me qira	1
3.	Kamion me vinç	Në pronësi ose me qira	1
4.	Mini eskavator	Në pronësi ose me qira	2
5.	Eskavator me goma (mjet teknologjik me goma)	Në pronësi ose me qira	1
6.	Dumper (mjet teknologjik me goma)	Në pronësi ose me qira	1
7.	Automjet për transport mjetesh kapaciteti mbajtës minimumi 4 ton	Në pronësi ose me qira	1
8.	Rrul me vibrim	Në pronësi ose me qira	1
9.	Autobot uji	Në pronësi ose me qira	1

10.	Fadromë (mjet teknologjik me goma)	Në pronësi ose me qira	1
11.	Karroca dore	Në pronësi ose me qira	8

*Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (sipas shtojcës 8).*

- Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet:

- a) leje qarkullimi;
- b) certifikatë e kontrollit teknik (e vlefshme);
- c) siguracion mjeti (i vlefshëm);

- Për mjetet e deklaruara me qira duhet të paraqitet:

- a) kontrata përkatëse e (qirasë/huapërdorjes e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi.
- b) leje qarkullimi;
- c) certifikatën e kontrollit teknik (e vlefshme)
- d) siguracion mjeti (i vlefshëm);

- Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes, ndërsa kur janë të marra me qira duhet të paraqitet kontrata e qirasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.

*Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit Nr. 8 të DST.*

*Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me Nenin 26, pika 7, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Regullave të Prokurimit Publik".*

Mjete janë të domosdoshme për realizimin e proceseve kryesore të punimeve dhe për përballimin e ndërhyrjeve në disa segmente njëkohësisht. Duke marrë në konsideratë numrin e mjeteve të kërkuara dhe shpërndarjen e punimeve në disa zona, ky numër përbën minimumin e nevojshëm për funksionimin normal të kantierit dhe zhvillimin paralel të proceseve të punës. Realizimi i punimeve është përcaktuar 3 muaj (duke marrë në konsideratë nevojën për përfundimin e punimeve përpara periudhës së reshjeve intensive të stinës së vjeshtës si dhe përfundimi i punimeve brenda këtij afati synon të garantoj sigurinë e aksesit të plotë dhe të shpejtë për ndërhyrje në kuadër të luftës kundra zjarrve e cila paraqet një rrezikshmëri të lartë në zonat pyjore në periudhën e verës).

**Argumentimi:** *Në bazë të nenit 77, pika 1 dhe pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" (i ndryshuar), autoriteti kontraktor vendos kritere për kualifikimin e operatorëve ekonomikë, të cilat duhet të jenë në përputhje dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, me qëllim vërtetimin kapaciteteve të nevojshme teknike për realizimin me sukses të kontratës.*

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

*Në të gjitha rastet kur AK në specifikimet teknike i është referuar vetëm standardeve europiane, Autoriteti Kontraktor do të pranojë edhe paraqitjen e standardeve SSH/DIN/EN/UNI/ISO.*

*Specifikimet teknike janë hartuar për çdo zë punimi të kësaj vepre sipas preventiveve të hartuara nga projektuesi, te cilat do të jene bashkelidhur DST-se.*

**\*Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim**